

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI I EDUKIMIT FIZIK DHE SPORTIT



PUNIM DIPLOME – MASTER

TEMA: NDIKIMI I INFRASTRUKTURES SHKOLLORE NË REALIZIMIN E DETYRAVE TË
LËNDËS EDUKATA FIZIKE DHE SPORTIVE NË KOMUNEN E VUSHTRISË

Mentore:

Prof. Dr. Shqipe Bajcinca-Brestovci

Studentja:

Antigona Idrizi

Prishtinë, tetor 2018

Përmbajtja

Hyrje.....	4
Abstrakti.....	7
Deklarata e autorësisë.....	9
Dedikimi dhe falenderimi.....	10
Kapitulli I-Metodologjia.....	11
1.1 Qëllimi.....	11
1.2 Objektivat.....	12
1.3 Pyetja kërkimore.....	12
1.4 Hipotezat.....	12
1.5 Mostra.....	12
1.6 Konsiderata etike.....	13
Kapitulli II-Edukimi fizik.....	14
2.1 Rëndësia e edukimit fizik.....	15
2.2 Detyrat e Edukatës Fizike.....	17
2.3 Historiku i edukimit fizik.....	18
Kapitulli III-Teoria dhe praktika e lëndës së Edukatës Fizike.....	19
3.1 Kurrikula Bërthamë.....	20
3.2 Plani vjetor.....	23
3.3 Programi i lëndës së Edukatës Fizike.....	24
3.4 Çështjet ndërkurrikulare.....	30
Kapitulli IV-Rezultatet.....	31
4.1 Niveli pedagogjik në komunën e Vushtrrisë.....	31
4.2 Posedimi i sallës së Edukatës Fizike.....	32
4.3 Gjendja ekzistuese e sallës së Edukatës Fizike.....	33
4.4 Posedimi i poligoneve sportive.....	34
4.5 Gjendja ekzistuese e poligoneve sportive.....	35
4.6 Hapësira e sallës së Edukatës Fizike.....	36
4.7 Hapësira e poligoneve sportive në shkollë.....	37
4.8 Pajisja me rekuizita sportive nëpër salla.....	38
4.9 Shfrytëzimi i rekuizitave.....	39
4.10 Niveli i rekuizitave.....	40

4.11 Posedimi i terreneve të hapura në shkolla.....	41
4.12 Shfrytëzimi i terreneve të hapura.....	42
4.13 Realizimi i planprogramit.....	43
4.14 Pjesëmarrja e nxënësve në orën e Edukatës Fizike.....	44
4.15 Harmonizimi i nivelit shkollor me planprogramin mësimor.....	44
4.16 Harmonizimi i nivelit të edukimit të arsimtarit me planprogramin mësimor.....	45
4.17 Zhvillimi i njësive mësimore.....	46
4.18 Zhvillimi i orës së Edukatës Fizike në teori.....	47
4.19 Zhvillimi i orës së Edukatës Fizike në praktikë.....	48
4.20 Ambientet e mbajtjes së orës mësimore.....	49
Diskutime.....	50
Përfundime.....	51
Kufizimet dhe rekomandimet.....	52
Bibliografia.....	53
Aneks-Pyetësori.....	54

Hyrje

Kultura fizike është pjesë e rëndësishme e kulturës së përgjithshme të një vendi (kombi) që ka vlera mbarë shoqërore dhe materiale të pasqyruara në institucionet shtetërore e shoqërore, si dhe në sistemet e edukimit fizik, të cilat janë të njohura në historinë e shoqërisë njerëzore.

Kur flasim për shkollat e edukimit fizik dhe të sportit në botë, kemi parasysh bashkësinë e karakteristikave të përmbajtjes e të vlerave, që kultivojnë ato te fëmijët, të rinjtë, te specialistët dhe shkenctarët e rinj.

Sikurse në të gjitha vendet e botës edhe tek ne edukimi fizik është lëndë e detyrueshme (obligueshme) mësimore në planet shtetërore dhe përfshinë të gjitha sistemet e arsimimit të brezit të ri, që nga mosha parashkollore deri në atë universitare, me një ngarkesë që shkon nga 2-5 orë mësimore në javë. Përmbajtja e kurrikulave të edukimit fizik karakterizohet nga katër elemente bazë: Aktiviteti (sportet, lojrat) lëvizorë tradicional.

Aktiviteti lëvizorë sportiv olimpik (sportet e ndryshme).

Veprimtaritë e organizuara dhe spontane jashtë klase dhe shkolle.

Njohuritë elementare bazë për kulturën fizike.

Për realizimin e aktiviteteve lëvizore sportive (te lartë përmendura), gjegjësisht realizimin e një ore mësimore të lëndës së edukatës fizike, nevojiten kushtet optimale të infrastrukturës shkollore konform plan-programit mësimor, gjë që kjo është mjaft e vështirë në vendin tonë, duke pasë parasysh gjendjen ekzistuese të infrastrukturës shkollore e cila ende nuk i përmbushë nevojat për realizimin e plotë të lëndës së edukatës fizike, andaj përmes këtij punimi do të njihemi për së afërmi rreth kësaj problematike.

Duke u nisur nga këto rrethana dhe faktorë të përmendur si metodë të punës që do të aplikohet në këtë hulumtim kemi parashikuar mes tjerash edhe Teorinë e Bazuar.

Teoria e bazuar- është paksa e pazakontë. “Në shumë drejtime, Teoria e bazuar nuk është gjë tjetër përveç se një mënyrë tjetër për mbledhjen e të dhënave”.¹

Mënyra më e mirë për ta përshkruar Teorinë e bazuar është ta trajtosh atë si metodë sistematike hulumtimi që gjeneron teorinë nga të dhënat. Ajo u zbulua nga sociologët amerikan Anselm Strauss-i dhe Barney Glaser-i. Ata e përshkruan këtë qasje si përpjekje për të mbushur hendekun midis

¹Matthews, Bob&Ross, Liz (2010). *Metodat e hulumtimit. Udhëzues praktik për shkencat sociale dhe humane*. Përkthyer. Majlinda Nishku dhe Ilir Nishku. Tiranë: Qendra për Arsim Demokratik, faqe 24.

teorisë dhe hulumtimit. Teoria e bazuar ka disa përbërës dhe procese mjaft unike, që mund të jenë me vlerë në hulumtimet e tjera, si për shembull: “

Idetë e lidhshmërisë, modifikueshmërisë dhe përdorshmërisë, që mund të jenë të dobishme si alternative të vlefshmërisë;

Ideja që mbledhja dhe analiza e të dhënave ndodhin në të njëjtën kohë;

Qasja që i jep mundësi hulumtuesit të punojë me burime dhe tipa të ndryshëm të dhënash në të njëjtën kohë, etj.”²

Arsyeja pse kemi përzgjedhur këtë formë është se hulumtimet sipas Teorisë së Bazuar fillojnë kur jeni në kontekst hulumtimi. Roli juaj si hulumtues është që të kuptoni proceset që po ndodhin dhe mënyrat se si sillen aktorët e ndryshëm në të. Metodatat më të zakonshme janë intervistat dhe vrojtimitet, ndonëse nuk ka ndonjë arsye pse të mos përdoren edhe metodatat e tjera cilësore. Në fund të secilit sesion të mbledhjes së të dhënave, mbahen shënimet dhe menjëherë përdoren si pjesë e një krahasimi të vazhdueshëm i cili, së bashku me kodimin dhe kujtesat, kanë rëndësi kyçe për procesin analitik. Fillimisht bëhet krahasimi i të dhënave nga burimet e ndryshme (ku, përveç gjetjeve empirike, mund të përfshihet edhe literaturë). Nëse mund të arrihet kjo ose jo, është një çështje e diskutueshme, por nuk ka dyshim se proceset e përdorura janë të dobishme, për shembull, krahasimi i vazhdueshëm është shpesh një mënyrë shumë e mirë për të identifikuar temat dhe kategoritë. Në të njëjtën kohë, hulumtuesi bën kërkim për rastet negative (shembuj që duket se janë në kundërshtim ose hedhin poshtë teorinë në krijim e sipër). “Kur (dhe në qoftë se) gjenden raste të tilla negative, kjo shihet si një tregues që duhen bërë hulumtime të mëtejshme (të cilat, nga ana e tyre, do ta modifikojnë teorinë në krijim) dhe se nuk është arritur pika e ngopjes së të dhënave.”³

Me anë të këtij punimi do të sjellim qasjet teorike të autorëve të ndryshëm lidhur me këtë çështje. Në pjesën e parë të këtij punimi do të paraqesim metodologjinë, qëllimin, objektivat, pyetjen e hulumtimit, hipotezat, mostrën dhe konsideratën etike të punimit. Ndërsa në kapitullin e dytë do të paraqesim konceptet e autorëve për historikun dhe rëndësinë e dukimit fizik. Në këtë kapitull poashtu do të trajtohet mënyra e funksionimit të edukimit fizik në procesin jetësor të individit dhe shoqërisë, pjesëmarrjen dhe rolin e mësimdhënësit apo trajnerit në ushtrimet fizike.

Në kapitullin e tretë trajtohet teoria dhe praktika e lëndës së Edukatës Fizike, procesi i edukimit fizik dhe rëndësia e tij edhe nga ana e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë me anë të hartimit të kurrikulës Bërthamë, planit vjetor për zhvillimin e lëndës, programin e lëndës dhe çështjet

²Matthews, Bob&Ross, Liz (2010). *Metodat e hulumtimit. Udhëzues praktik për shkencat sociale dhe humane*. Përkthyer. Majlinda Nishku dhe Ilir Nishku. Tiranë: Qendra për Arsim Demokratik, faqe 25.

³ Po aty, faqe 26.

ndërkurrikulare. Këtu trajtohen disa çeshtje bazë se si duhet të zhvillohet dhe çka pritet nga mësimdhënia dhe mësimnxënia në lëndën e Edukatës Fizike.

Kurse kapitullin e katërt janë përshkruar gjetjet në mostrën pjesëmarrëse në këtë punim që ishin gjashtëmbëdhjetë shkolla pjesëmarrëse.

Diskutimin dhe interpretimin e rezultateve të analizës janë të përshkruara pas përfundimit të këtij kapitulli, ndërsa përfundimi së bashku më rekomandimet janë të shkruara në fund të punimit.

Abstrakti

Qëllimi i këtij punimi ishte gjetja e rezultateve që tregojnë mbi ndikimin e infrastrukturës për mbajtjen dhe zhvillimin e lëndës së Edukatës Fizike në komunën e Vushtrrisë.

Punimi është kryer me një mostër prej gjashtëmbëdhjetë shkollave pjesëmarrëse të kësaj komune, duke përfshirë edhe qytetin por edhe disa nga fshatrat. Kemi përzgjedhur metoda të kombinuara duke filluar prej analizës së Teorisë së Bazuar për të shpjeguar ndikimin dhe rëndësinë e sportit në jetën e njeriut, dhe për të kaluar edhe te metoda kuantitative për të matur gjendjen reale të infrastrukturës së shkollave për mbajtjen e lëndës së Edukatës Fizike. Nga rezultatet del se janë vërtetuar të tri hipotezat:

Infrastruktura ndikon shumë në realizimin e planprogramit shkollorë për zhvillimin e edukimit fizik. Gjendja reale e infrastrukturës për mbajtjen e edukimit fizik në komunën e Vushtrrisë është e dobët. Në komunën e Vushtrrisë ka mungesë elementare në infrastrukturën e edukimit fizik.

Gjetjet e hulumtimit rezultojnë se infrastruktura sportive është e domosdoshme për të realizuar planprogramin e lëndës së Edukatës Fizike në shkolla. Madje në hulumtim pohohet se niveli i përgatitjes profesionale të personelit për dhënien e mësimit është shumë më lart se infrastruktura për të zhvilluar mësim. Nga gjashtëmbëdhjetë shkolla të përfshira në mostër, vetëm një prej tyre posedon sallën e Edukatës Fizike.

Fjalët kyce: Infrastruktura, Edukimi fizik, salla e sportit, kurrikula etj.

Abstract

The aim of this research was to find the results that showed the influence of infrastructure to maintaining and developing the Physical Education in the municipality of Vushtrri. The research was done with a sample of sixteen participating schools of this municipality, including the city school and as well as some schools from villages. We have selected some combined methods starting from the analyses of based theory to explain the influence and the important of sport in human life, we have used the quantitative method to measure the real infrastructure of schools to keep the Physical Education subject. The result shows that all hypotheses are true:

1. The infrastructure has a big influence on the realization of Physical Education curriculum.
2. The real situation of infrastructure to maintain the Physical Education in Vushtrria's municipality is in bad condition.
3. In this municipality there is an elementary lack of Physical Education infrastructure.

The results show that the sport infrastructure is necessary to realize the curriculum of Physical Education subject. Even the results showed the level preparation of professional teaching staff that is higher than the infrastructure of developing learning. From sixteen schools included in this research only one of them has got a Physical Education hall.

Key words: Infrastructure, Physical Education, sport's hall, curriculum etc.

Deklarata e autorësisë

Unë, Antigona Idrizi, deklaroj me vetëdije të plotë se të dhënat e këtij punimi janë origjinale të kryera nga unë dhe se citimi i literaturës është konform rregullave të citimit dhe në përputhje me statutin e Universitetit “Hasan Prishtina”.

Dedikimi dhe falenderimi

Falenderimet më të larta i takojnë Zotit që më mundësoi të realizoj ëndrren time, më dhuroi shëndet dhe dije për arritjen time deri në këtë nivel.

Një falenderim të veçantë kam për prindërit e mi për ndihmen dhe mbështetjen e vazhdueshme.

E falenderoj Mentoren e temës prof.Dr.Shqipe Bajçinca dhe të gjithë anëtarët e komisionit për vrojtimitet profesionale gjatë punimit të temës së diplomës Master.

Këtë punim ua dedikoj prindërve të mi që më kanë edukuar, për besimin që kanë treguar dhe që nuk kanë kursyer asgjë për edukimin tim, duke më liruar nga të gjitha obligimet familjare.

Kapitulli I-Metodologjia

Për realizimin e këtij punimi është përzgjedhur metoda cilësore dhe sasore, e orientuar në një rrafsh analitik, metodë që synon të nxjerr në pah informacionin cilësor dhe sasiorë rreth synimit tonë për infrastrukturën e edukimit fizik. Metoda cilësore na mundëson matjen e ngajshmërive dhe pikëpamjeve të opinioneve dhe shpjegimin e tyre edhe nga qasja teorike e autorëve të fushës së edukimit fizik dhe njohësve të fushës së edukimit fizik. Ndërsa, analizën e kemi punuar në bazë të Teorisë së Bazuar. Gjithashtu, janë përdorur informacione nga burime të ndryshme, si libra, artikuj, websitë dhe artikuj shkencor. Ndërsa metoda sasore na mundëson të kemi një pasqyrë rreth infrastrukturës në shkolla, që nga kualifikimet e mësimeve duke matur se sa janë të përgatitur për ushtrimin e kësaj veprimtarie e deri te sasia e pajisjeve për ushtrimin e lëndës së Edukatës Fizike në shkollat e komunës së Vushtrrisë.

1.1 Qëllimi

Qëllimi i këtij punimi është analizimi se si është gjendja reale e zhvillimit të lëndës së Edukatës Fizike në komunën e Vushtrrisë. Analiza do të fokusohet në 16 shkolla të komunës së Vushtrrisë. Pra, qëllimi është gjetja e rezultateve dhe identifikimi se si zhvillohet lënda mësimore e edukimit fizik në këtë komunë.

Poashtu qëllimi i këtij hulumtimi ka të bëjë me ndikimin e infrastrukturës sportive shkollore në realizimin e planprogramit të lëndës së Edukatës Fizike dhe Sportit në Komunën e Vushtrrisë.

Qëllim tjetër i këtij hulumtimi është të dihet sa realizohen kategoritë nga syllabusi i lëndës së Edukatës Fizike dhe Sportit duke iu referuar infrastrukturës.

Parësore e këtij hulumtimi është të arrijmë të bëjmë vlerësimin e infrastrukturës sportive nëpër shkolla, gjithashtu duhet të vërtetojmë nëpërmjet parametrave të parashtruar në këtë punim se si infrastruktura e sportit ndikon në zhvillimin dhe aftësimin e nxënësve për lëndën e Edukatës Fizike dhe Sportit.

Si ndikon kjo infrastrukturë në shëndetin dhe mirëqenien e fëmijëve. Duke u nisur nga rëndësia që ka infrastruktura shkollore për realizimin sa më të suksesshëm të planprogramit mësimor të lëndës së Edukatës Fizike në një vend, e në këtë rast në Komunën e Vushtrrisë, me anë të këtij hulumtimi si qëllim tjetër i këtij studimi është që të njihemi më afër me probleme të ndryshme rreth infrastrukturës shkollore (gjendjen aktuale), rreth harmonizimit të planprogramit mësimor, zhvillimin e njësive mësimore, harmonizimin e planit mësimor me nivelin shkollor si dhe me nivelin e edukimit (shkollimit) të mësimeve në nivelin fillor dhe atë të mesëm.

1.2 Objektivat

Si objektivë të këtij punimi është shpjegimi përmes analizimit se si zhvillohet mësimi i edukimit fizik dhe cila është infrastruktura për ushtrimin e kësaj lëmie.

Të tregojë nivelin e përgatitjes së mësimitdhënësve;

Të vlerësojë rolin e mësimitdhënësve në mbajtjen e edukimit fizik;

Të vlerësojë rolin e kushteve për mbajtjen e kësaj lënde;

Cilësia e zhvillimit të edukimit fizik në komunën e Vushtrrisë;

1.3 Pyetja kërkimore

Si ndikojnë kushtet infrastrukturore në mbarëvajtjen e lëndës së Edukatës Fizike në komunën e Vushtrrisë”?

1.4 Hipotezat

Infrastruktura ndikon shumë në realizimin e planprogramit shkollorë për zhvillimin e edukimit fizik. Gjendja reale e infrastrukturës për mbajtjen e edukimit fizik në komunën e Vushtrrisë është e dobët.

Në komunën e Vushtrrisë ka mungesë elementare në infrastrukturën e edukimit fizik.

1.5 Mostra

Për të realizuar këtë projekt si mostër kemi disa shkollat fillore dhe të mesme të Komunës së Vushtrrisë, përfshirë edhe në disa vende rurale të kësaj komune të cilat zhvillojnë mësimin e rregullt në orët e Edukatës Fizike dhe Sportit.

Grupin e shkollave pjesëmarrëse nga qyteti e përbëjnë këto shkolla:

- 1.Gjimnazi “Eqrem Çabej”
- 2.Shkolla e mesme profesionale “Bahri Haxha”
- 3.Shkolla e mesme teknike “Lutfi Musiqi”
4. SH.M.U “Andon Zako Çajupi”
5. SH.M.U “2”

Grupin e shkollave pjesëmarrëse nga fshatrat e përbëjnë këto shkolla:

- 6.SH.F.M.U “Jusuf Gërvalla”-Dumnicë
7. SH.F.M.U “Nadakocë ”-Nadakovc
8. SH.F.M.U “Mustafë Shyti”-Oshlanë

9. SH.F.M.U “Emin Duraku”-Novolan
10. SH.F.M.U “7 Marsi”-Bukosh
11. SH.F.M.U “Rilindja”-Maxhunaj
12. SH.F.M.U “Martirët”-Reznik
13. SH.F.M.U “ Abdyl Frashëri”-Druar
14. SH.F.M.U “Liria”-Strofc
15. SH.F.M.U “Gjergj Kastrioti-Skënderbeu”-Pantinë
16. SH.F.M.U “Akrashticë”-Akrashticë

Në komunën e Vushtrrisë janë gjithsej 34 shkolla ku prej tyre 3 janë shkolla të mesme ndërsa 31 janë shkolla fillore.

1.6 Konsiderata etike

Pjesëmarrësit e pyetësorit fillimisht janë kontaktuar dhe njoftuar për kohën dhe procedurën e realizimit të tij dhe arsytet e kryerjes së pyetësorit. Atyre u është dhënë çasje në rezultatet e punimit pas përfundimit të hulumtimit.

Kapitulli II-Edukimi fizik

Edukimi fizik është i një rëndësie të veçantë. Sipas autorit Brettschneider, dy gjërat vendimtare të edukimit fizik janë mundësimi i jetës aktive dhe përgatitja për jetën. “Edukimi fizik duhet të zhvillojë fitnesin fizik dhe aftësitë lëvizore deri në atë nivel që mundëson të rinjtë të ndjekin një stil aktiv të jetës. Edukimi fizik duhet t’i kontribuojë zhvillimit të përgjithshëm social, kognitiv, dhe emocional të të rinjve në përgatitjen e tyre për tërë jetën.”⁴ Ndërsa për autorët Harris dhe Elbourn konceptet e edukimit fizik dhe shëndetësor janë të lidhura ngusht me ushtrimet e shëndetit të cilat zhvillohen, që do të thotë se është mësuar përmes ushtrimit. Në këto aktivitete përfshihen grupi i fushave “të aktiviteteve të EF(atletikës, vallëzimit, lojërave, gjimnastikës, notit, dhe aktiviteteve, tjera në natyrë dhe aventureske).”⁵ Nga ana tjetër autori Silverman sygjeron karakterisitka për të mësuar efektshëm aftësitë motorike. Sipas tij këtu hyjnë:

“Planifikimi për menagjimin e klasës dhe të mësuarit e nxënësve.

Parashikimi i situatave dhe planet mbi të paparashikuaren.

Vetëdijesimi rreth dallimeve individuale në aftësitë e studentëve dhe përdorimi i këtij informacioni në planifikim dhe monitorim.

Përvetësimi i informacionit për të planifikuar.

Njohuritë rreth përdorimit të repertorit të metodave të mësimdhënies.”⁶

Mbi këto premisa dhe në linjë të asaj se çka thonë këta autorë është e zhvilluar edhe pedagogjia sportive. Kjo ka të bëjë me të mësuarit në praktikë. “Në përgjithësi pedagogjia ka të bëjë me të mësuarit në praktikë, ajo i referohet dy mënyrave: se si individët mësojnë dhe njohurive pedagogjike dhe aftësive të trajnerëve dhe mësimdhënësve që posedojnë për të dhënë njohuri në mënyrë më efektive.”⁷ Ani pse Edukata Fizike si e tillë ka marrë më vonë statusin e sistemit baraz me shkencat tjera, ajo si e tillë ka ekzistuar qysh në kohërat e vjetra, ku njerëzit kanë zhvilluar veprimtari fizike dhe motorike. “Ajo është aplikuar në forma të ndryshme, për nderë të manifestimeve të ndryshme, dhe për qëllime të ndryshme, varësisht prej stadiumit shoqëror të zhvillimit duke filluar nga ajo primitive e deri tash.”⁸

⁴ Vehapi Shemsedin, “Konceptet e Edukimit Fizik dhe Edukimit Shëndetësor”, Universiteti “Hasan Prishtina”, ligjeratë e autorizuar, Prishtinë 2014, faqe 2.

⁵ Po aty, faqe 3.

⁶ Po aty, faqe 4.

⁷ Bajçinca-Brestovci Shqipe, “Pedagogjia sportive”, Universiteti “Hasan Prishtina”, ligjeratë e autorizuar, Prishtinë 2014, faqe 1.

⁸ Hasangjekaj Beqir, “Metodika e edukatës fizike”, botues, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë 1998, faqe 13.

2.1 Rëndësia e edukimit fizik

Edukimi fizik ka rëndësi të madhe për individin dhe për shoqërinë për shumë arsye. Ndër arsyet kryesore janë se ruan shëndetin e individit dhe shoqërisë që janë bazament për të vazhduar të ushtrohen profesione të tjera, meqë shëndeti është i mishëruar me edukimin fizik, dhe veprimet që bën individi me trupin e tij. Duke ndërlidhur këto por edhe faktet se edukata fizike është e lidhur ngushtë me shkencat natyrore si:

“Antropologjinë, e cila studion veçoritë biologjike të njeriut.

Morfologjinë, e cila studion trajtën dhe ndërtimin e brendshëm të organeve në organizmin e njeriut.

Biokiminë, e cila studion ndërtimin dhe veprimtarinë fiziologjike të sistemeve të organizmit të njeriut (sistemin kardiovaskular, respiratorë, aparatit lëvizorë, endokrin etj.)

Nga shkencat sociale duhet cekur: Historinë, e cila studion lindjen dhe zhvillimin e shoqërisë krahas me këtë edhe historinë e edukatës fizike.”⁹ Rëndësia e edukimit fizik është e mishëruar me lëndët tjera dhe kontinuele me to. Çka studiohet në lëmitë e tjera studiohet edhe në edukimin fizik.

Shembull: “

Edukimi Fizik	Biologjia
<p>- Vlerësimi i niveleve të pamjes fizike, përshtatja e aktivitetit me moshën, rritjen dhe zhvillimin fizik.</p> <p>- Identifikimi i muskujve kryesorë (primarë) lëvizës, muskujve të kundërt dhe stabilizues për çdo ushtrim kryesor të trajnimit me pesha.</p>	<p>- Nxënësi/ja duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të njohë ç’është moshja, koncepti i saj; - të njohë etapat e zhvillimit të qenieve humane, femra - meshkuj; - të njohë sistemin kardiovaskular; - të njohë konceptin e ushqimit dhe të të ushqyerit; - të njohë ligjet themelore të trashëgimisë genetike edhe në fushën e edukimit fizik e të sportit. <p>Nxënësi/ja duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të njohë sistemin lokomotor; - të njohë muskujt kryesor të trupit. <p>Nxënësi/ja duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të njohë sistemin senso-perceptiv;
<p>- Njohja me aftësitë e lidhura me ekuilibrin, kohën e reagimit, koordinimit dhe shpejtësisë.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - të njohë sistemin nervor (qëndror dhe periferik); - të njohë sistemin endokrin.
Edikimi Fizik	Fizika

⁹ Po aty, faqe 13.

<p>- Njohja me parimet bazë të biomekanikës së lëvizjeve të njeriut.</p>	<p>Nxënësi/ja duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të njohë ligjet e Njutonit, levat dhe teoritë e tyre, lëvizjet traslatore dhe rrethore; - të njohë ç’është pluskimi i trupave; - të njohë konceptin e fuqisë, forcës, shpejtësisë, amplitudës, frekuencës dhe ritmit
<p>Edukimi Fizik</p>	<p>Artet</p>
<p>Njohuri mbi vallëzimin: klasik, modern, folklorik.</p>	<p>Nxënësi/ja duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të njohë vallëzimin klasik; - të njohë dancin klasik dhe modern; - të njohë vallet popullore; - të njohë ç’është melodia; - të njohë ç’është ritmi; - të njohë ç’është harmonia.
<p>Edukimi Fizik</p>	<p>Qytetë ria</p>
<p>- Njohja me faktorët fizikë, emocionalë dhe të formimit intelektual, si dhe me ndikimet e tyre në paraqitjen individuale dhe kolektive.</p> <p>- Aktiviteti fizik, sporti dhe shumëkulturalizmi.</p>	<p>Nxënësi/ja duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të njohë konceptet si individ, shoqëria, grupi shoqëror; - të njohë konceptin aktivitetet shoqërore; - të njohë konceptin përgjegjësia e individit ndaj grupit dhe anasjellas. <p>Nxënësi/ja duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të njohë konceptin kulturë; - të njohë konceptin shumëkulturalizëm; - të njohë konceptet mbi besimet fetare.
<p>- Fair play.</p>	<p>Nxënësi/ja duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të njohë çfarë është rregulli, rregullat dhe rregulloret; - të njohë kuptimin ndaj ligjit dhe respektit për të; - të njohë çfarë do të thotë të respektosh të tjerët dhe vetveten

<p>Realizimi dhe vlerësimi i rolit të paracaktuar ose spontan të lidershit në aktivitete fizike dhe në sport.</p>	<p>Nxënësi/ja duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të njohë konceptet mbi lidershipin, përmasat e tij dhe raportin me grupin e shoqërinë.
---	---

»10

2.2 Detyrat e Edukatës Fizike

Njohësit e fushës së edukimit fizik detyrat e Edukatës Fizike i ndajnë në dy grupe, në detyra biologjiko-shëndetësore (higjenike), dhe në detyra pedagogjike.

Në grupin e detyrave biologjiko-shëndetësore (higjenike) bëjnë pjesë:

“Zhvillimi i gjithanshëm i organeve të organizmit të njeriut.

Formimi dhe rruajtja e shëndetit të njeriut.

Formimi dhe rruajtja e të mbajturit të drejtë të trupit.

Përmirësimi kualitativ i funksioneve fiziologjike të sistemeve të ndryshme.

Formimi i imunitetit të organizmit ndaj sëmundjeve dhe “çelikosja”.

Sigurimi i pushimit aktiv.

Përvetësimi i shprehive higjenike (pastrim, kultivim i trupit, veshmbathje, ushqim etj.)¹¹

Ndërsa në grupin e detyrave pedagogjike sipas tyre ndahen në dy nëngrupe tjera, në detyra arsimore dhe në detyra edukative. Zbatimi i këtyre detyrave arsimore duhet të jetë në atë formë që “mësimi i edukatës fizike, me përmbajtjet programore të përmbledhura në bazë të moshës, gjinisë, aftësive psikomotorike dhe teknikosportive, në aspektin arsimorë ka për detyrë:

Zhvillimin e lëvizjeve koordinuese (koordinimin e lëvizjeve).

Formimin e shprehive motorike.

Perfeksionimin e shprehive motorike.

¹⁰ Sallauku Dritan, Baze Elvira, “Edukimi Fizik dhe Sporte”, Republika e Shqipërisë, Instituti i Zhvillimit të Arsimit, Udhëzues Kurrikularë, Tiranë 2010, faqe 21-23.

¹¹ Po aty, faqe 24

Zhvillimin e forcës, shpejtësisë, rezistencës, dhe lëvizshmërisë.

Përsosjen e organeve endokrine.

Sigurimin e diturive teorike.”¹²

Kurse në detyra edukative janë paraparë:

“Edukimi i moralit bashkëkohor (krijimi i marrëdhënies pozitive ndaj punës, krijimi i disiplinës dhe punës së vetëdijshme, krijimi i marrëdhënies pozitive ndaj pasurisë shoqërore dhe private, humanizmi, patriotizmi, internacionalizmi etj.)

Zhvillimi i aftësisë për edukim estetik (shijimi i të bukures).

Zhvillimi i vullnetit.

Orientimi i drejtë në zgjedhjet e vetive morale.

Sigurimi i aktiviteteve argëtuese dhe pushimit aktiv.

Vetë mësimdhënësi i cili është i njohur dhe i cili ka të njohura e të përvetësuara detyrat e cekura të mësimit do të jetë në gjendje që me sukses të bëjë planifikimin dhe programin e mësimit, si dhe realizimin e të gjitha detyrave që duhet t’i realizojë në atë moment me nxënësit.”¹³

2.3 Historiku i edukimit fizik

Përgjatë zhvillimit historik shumë autorë dhe pedagogë të kësaj fushe kanë lënë gjurmë dokumente dhe shënime që tregojnë për rëndësinë e edukatës fizike të baras vlefshme me shkencat e tjera. Edhe në Republikën e Kosovës i është kushtuar një rëndësi e veçantë sportit. Madje prej vitit 1979 Kosova ka themeluar Fakultetin e Kulturës Fizike.

“Fakulteti i Kulturës Fizike është themeluar në korrik të vitit 1979, ndërkohë që punën e ka filluar më 1 nëntor 1979. Në vitin e parë të studimeve, respektivisht në vitin e themelimit dhe në vitin shkollor 1979/80 janë regjistruar 88 studentë.

Këtë vit shkollor fakulteti e ka filluar punën me katër mësimdhënës, një asistent dhe një asistent praktikant, kurse një pjesë tjetër e procesit mësimor është mbuluar me bashkëpunëtorë të jashtëm.

Në vitin 2001, Senati i Universitetit të Prishtinës miratoi planet mësimore të mbështetura në Deklaratën e Bolonjës për nivelin Bachelor.

Në shtatorin e vitit 2004 u miratua plani mësimor për studime në nivelin Bachelor dhe në atë Master.

Në këtë vit akademik FKFS-ja ka të regjistruar 286 studentë. Në procesin mësimor janë të angazhuar

¹² Hasangjekaj Beqir, “Metodika e edukatës fizike”, botues, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë 1998, faqe 24

¹³ Po aty, faqe 25.

23 mësimdhënës e asistentë në marrëdhënie të rregullt pune dhe 7 me punë plotësuese dhe të angazhuar.

Fakulteti është themeluar i shkallëzuar, kështu që ka përgatitur kuadër me kualifikim të lartë dhe superior. Deri më tani vetëm në Fakultetin e Kulturës Fizike kanë diplomuar 721 studentët me mësim në gjuhën shqipe.”¹⁴

¹⁴ Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit, “Historiku i Fakultetit”, qasur në internet me datën 20.09.2018, ora 12:45, e qashme edhe në internet, <https://fshs.uni-pr.edu/Historiku.aspx>

Kapitulli III- Teoria dhe praktika e lëndës së Edukatës Fizike

Edukata Fizike luan një rol kyç në shëndetin e individit dhe është pjesë e pandashme e formimit të tij fizik dhe mendor. Përmes teorive, nxënësi në këtë rast, përforcon njohuritë dhe siguron përvoja të reja të aftësimin për vlerësim dhe veprim fizik, ai krijon një përforcim në krijimin e marrëdhënieve shoqërore dhe kupton rëndësinë e shoqërisë dhe të vepruarit në grup. Edukata fizike kërkon që përmes studimit edhe të lamive të tjera siç janë fushat sociale, shkenca dhe arti, të arrihet formësimi i nxënësit së në aspektin kulturorë, logjik dhe fizik. Teoria i mundëson nxënësit që të vlerësojë efektet pozitive në shumë dimensione, dhe jo vetëm në aspektin fizik dhe shëndetësor, por shembull edhe në aspektin historik, zgjerimin e njohurive për kulturat e ndryshme të botës dhe mënyrës se si kanë ndryshuar ato. Poashtu në krijimin e një kulture të re e fituar nga baza e kombinimit të ideve dhe sporteve të ndryshme, siç edhe kanë lindur shumë sporte dhe lojëra më vonë.

Nga ana tjetër praktimi i aktiviteteve fizike siguron që nxënësi të ndjekë urtë, maturi dhe sjellje korrekte me grupin. Një përparësi tjetër e ushtrimeve fizike dhe lojërave është se detyrimisht nxënësi obligohet që t'i vë theks të veçantë pastërtisë së trupit të tij, të kujdeset për higjienen orale dhe trupore pas aktiviteteve fizike, e kjo siguron që nxënësi do të rritet me një kulturë vetëdijesuese mbi rëndësinë e shëndetit dhe pastërtisë e që parandalohen shumë sëmundje të ndryshme. Kjo sjellje (kulturë) e fituar në praktikimin e lëndës së Edukatës Fizike do t'i shërbejnë individit gjatë gjithë jetës.

3.1 Kurrikulla Bërthamë


Kurrikula Bërthamë është një dokument me anë të cilit bëhet e zbatueshme Korniza Kurrikulare e miratuar nga MASHT-i në vitin 2016. Me anë të këtij dokumenti janë të përcaktuara edhe mënyra dhe fushat me anë të së cilave duhet të vepruar për të arritur rezultatete në mësimdhënie dhe mësimnxënie. Këtu përcaktohen edhe metodologjia zbatueshmëria, monitorimi dhe vlerësimi për të gjitha lëndët veç e veç. Ndërkohë këtu është përcaktuar edhe fusha kurrikulare për Edukatën Fizike si në vijim: “

KURRIKULA BËRTHAMË

E ARSIMIT TË MESËM TË ULËT TË KOSOVËS

4. Rezultatet e të nxënit

REZULTATET MËSIMORE PËR SHKALLËT 3 DHE 4	
Shkalla 3 Klasa 6,7 (mosha 11-13)	Shkalla 4 Klasa 8,9 (mosha 13-15)
Mirëqenia e plotë fizike, psikike, emocionale dhe sociale.	
1. Shpjegon dhe analizon veprime konkrete për ruajtjen e mirëqenies fizike, psikike, emocionale dhe sociale të tij/saj dhe të tjerëve (në familje, me koleget dhe anëtarët e komunitetit) në situata të ndryshme.	1. Identifikon persona dhe shërbime në mjedisin ku jeton dhe di ku të kërkojë shërbime dhe mbështetje profesionale për të ruajtur mirëqenien fizike, psikike, sociale dhe emocionale.
Zhvillimi i gjithanshëm dhe harmonik i trupit përmes aktiviteteve fizike	
1. Demonstron shkathtësi gjatë ushtrimit të teknikave në disiplina sportive (atletikë, gjimnastikë, sportet luftarake etj.) duke përforcuar shkathtësitë psikofizike individuale dhe kolektive me kombinime lëvizore dhe përfshirje të formave të ndryshme të lëvizjes.	1. Merr pjesë aktive në disiplina të ndryshme sportive (atletik, gjimnastikë, sportet luftarake etj.) dhe aplikon përvoja e fituara në mënyrë të rregullt përmes aktiviteteve fizike dhe krijon kombinime lëvizore me përfshirje të formave të ndryshme të lëvizjes.
2. Liston, përshkruan rregullat elementare të sporteve të ndryshme kolektive dhe demonstroi shkathtësi gjatë ushtrimit të elementeve teknike në sportet kolektive.	2. Përshkruan, zbaton dhe ndërlik rregullat e sporteve kolektive duke përforcuar shprehitë motorike dhe shkathtësitë lëvizore gjatë ushtrimit të taktikave të sportet kolektive.
Promovimi i stilit aktiv dhe të shëndetshëm të jetës	
1. Hulumton sistemin e klasifikimit të ushqimit të etiketuar, kupton që njerëzit kanë nevoja të ndryshme për ushqim dhe nevojat e tyre ndryshojnë në etapa të ndryshme të jetës se si duhet të ushqehen.	1. Identifikon nëpërmjet aktiviteteve praktike, përbërësit kryesorë të ushqimit, prejardhjen (burimin) e tyre, funksionin dhe përshkruan lidhjen në mes të energjetikës, ushqimit dhe shëndetit fizik.
Vetëdijësimi për ndikimin e përdorimit të substancave që krijojnë varshmëri	
1. Njeh dhe dallon situatat e rrezikshme dukuritë dhe shprehitë negative (substancat negative duhani, alkooli dhe drogat) dhe kupton mënyrën për parandalimin e tyre.	1. Kupton efektet pozitive që disa substanca mund të ketë në mendjen dhe trupin, por gjithashtu është i vetëdijshëm për pasojat negative dhe të rënda fizike, mendore, emocionale, sociale dhe juridike që ka keqpërdorimi i substancave.
Edukimi mbi mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm	
1. Njeh burimet natyrore, rregullat e sjelljes, në natyrë, në kampe dhe shfrytëzon ato për zhvillim të aftësive fizike.	1. Përdor burimet natyrore për zhvillimin e aftësive fizike dhe shëndetit, duke u kujdesur për respektuar mjedisin ku vepron.



KURRIKULA BËRTHAMË

E ARSIMIT TË MESËM TË ULËT TË KOSOVËS

II. Njohuritë dhe shkathtësitë


- Njeh veten dhe të tjerët
- Kupton veten dhe të tjerët
- Tregon për veten, për familjen dhe për mjedisin
- Identifikon rreziqet e ndryshme
- Kupton ndikimin e veprimeve pozitive dhe negative
- Shpjegon ndikimin e aktiviteteve sportive
- Emërton pjesët e trupit
- Shpjegon emocionet
- Shkëmben përvojat
- Diskuton
- Pjesëmarrje aktive
- Ushtron të drejtat e veta
- Shpjegon
- Menaxhon emocionet
- Demonstron sjellje, veprime, shprehi
- Zbaton principet
- Përshkruan llojet e ushqimit, aktivitetet fizike
- Qëndrim të drejtë trupor
- Praktikon ushtrime
- Ndërton bashkëpunim
- Harton rregullore
- Hulumton

III. Qëndrimet, vlerat dhe besimet

- Respekton veten dhe të tjerët
- I përgjegjshëm
- Tolerant
- Respektim i diversitetit
- I përkushtuar
- Qëndrim pozitiv
- Bashkëpunues
- Respekton kodin e mirësjelljes
- Respekton kodin e veshjes
- Respekton rregulloret
- Gatishmëri
- I sigurt

KURRIKULA BËRTHAMË

E ARSIMIT TË MESËM TË ULËT TË KOSOVËS



IV. Njohuritë dhe konceptet

- Elementë të lëvizjes
- Lëvizje manipulative
- Lëvizje lokomotorë
- Lëvizje jolokomotorë
- Lojë lëvizore
- Rregulla të lojës
- Lojë tradicionale (popullore)
- Morali i lojës
- Lojëra sportive
- Marshim në natyrë
- Higjiena personale
- Veshja e përshtatshme
- Drejtqëndrime
- Rregullat e sigurisë
- Ndihma e parë
- Mënyra të të ushqyerit
- Shëndetësore
- Edukimin fizik,
- Shëndet mendor
- Shëndet emocional
- Shëndet social
- Shëndeti personal
- Zakonet/shprehjet e të ushqyerit
- Përmirësimi i shëndetit
- Stilet e shëndetshme jetësore
- Edukim olimpik - "Fair-Play"
- Substanca që krijojnë varshmëri
- Mënyra të drejta të përdorimit të substancave
- Mjedisi që na rrethon
- Planifikim
- Karrierë

¹⁵ Republika e Kosovës, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, “Kurrikula Bërthamë”, gusht 2016, faqe 77-79.

3.2 Plani vjetor

Plani vjetor hartohet nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

“Plani vjetor është dokument, i cili e orienton zhvillimin e mësimit për një vit shkollor duke i përbushur kërkesat e shkallës kurrikulare, duke i ndarë, apo duke i thjeshtuar, për klasën e caktuar. Ai hartohet për secilën fushë kurrikulare, pra edhe për fushën Edukatë fizike, sport dhe shëndet, dhe ka për qëllim identifikimin e rezultateve të të nxënit të kompetencave, të cilat mund të jenë synim arritjeje, gjatë një viti shkollor (mësimor). Ka për qëllim po ashtu edhe identifikimin e temave të cilat shpërndahen në plane dymujore, në tri periudha mësimore në funksion të arritjes së rezultateve të të nxënit të fushës kurrikulare dhe të rezultateve të të nxënit të kompetencave të identifikuar.”¹⁶

Në këtë plan theksohet se përmbajtja mësimore duhet të jetë në funksion të mësimdhënies së integruar brenda fushës kurrikulare Edukatë fizike, sport dhe shëndet, por edhe të fushave të tjera kurrikulare. Puna me tema të përbashkëta mësimore, brenda fushës kurrikulare, dhe lidhshmëria me temat mësimore të fushave të tjera kurrikulare të jenë në linjë me mësimdhënien dhe mësimnxënien e integruar. Ky dokument thekson se “temat mësimore janë tërësi mësimore, të cilat i mbulojnë apo i përfaqësojnë të gjitha tematikat mësimore brenda një fushe kurrikulare-lënde. Por, gjatë identifikimit të rezultateve të të nxënit të fushës kurrikulare Edukatë fizike, sport dhe shëndet, mësimdhënësit mund të hasin në rezultate që anojnë më tepër te një tematikë mësimore dhe në këtë rast ndonjë temë mësimore edhe mund t’i dedikohet vetëm një tematike mësimore. Megjithatë, qasja e KKK-së është e orientuar drejt mësimdhënies dhe nxënies së integruar, prandaj gjithmonë duhet synuar në përcaktimin e temave mësimore, të cilat janë reprezentative për të gjitha tematikat mësimore të fushës kurrikulare (Edukatë fizike, sport dhe shëndet). Temat mësimore mund të jenë të pranishme në një, apo disa muaj të vitit shkollor (mësimor).”¹⁷

Plani vjetor përmbanë këto elemente: Temat mësimore që trajtohen gjatë një viti mësimor. Temat shpërndahen (organizohen) në 5 cikle dymujore të ndara në tri periudha.

¹⁶ Republika e Kosovës, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, “Udhëzues për zbatimin e kurrikulës, Fusha kurrikulare, Edukatë Fizike, Sportet dhe Shëndeti”, Tetor 2016, faqe 37.

¹⁷ Po aty, faqe 37.

3.3 Programi i lëndës së Edukatës Fizike

Sipas kurrikulës së krijuar nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, përmbajtja programore e lëndës së Edukatës Fizike duhet të jetë në atë formë ku do të jenë të përfshira teoria dhe praktikimi i sporteve në këtë formë:

PËRMBAJTJA PROGRAMORE	Nr. i orëve
VLERËSIMI I AFTËSIVE LËVIZORE	4 orë
ATLETIKË	12orë
GJIMNASTIKË SPORTIVE DHE RITMIKE	14 orë
SPORTET KOLEKTIVE	24 orë
SPORTET INDIVIDUALE	12orë
- sportet luftarake	
- sportet me raketë	8 orë
SKIJIMI-NOTIMI ¹⁸	7-10 ditë
PIKNIQET DHE FUSHIMI	2 ditë në vit
GARA SPORTIVE SË PAKU NË DY SPORTE (SIPAS KUSHTEVE)	

¹⁸ Mësimi organizohet në terren të përshtatshëm për ski e not në bashkëpunim me drejtorinë e shkollës, prindërit dhe institucionet e tjera

KATEGORITË	NËNKATEGORITË	PËRMBAJTJET PROGRAMORE	Numri i orëve (%)
ANTROPOMETRI DHE MOTORIKË	Vlerësimi i veçorive antropometrike dhe i aftësive lëvizore	(A) -Pesha e trupit (PT), - Lartësia e trupit (LT), etj. (M) - Kërcim nga vendi në gjatësi,(KVGJ) - Kërcim nga vendi në lartësi (KVL), - Vrapim 100 metra(V100m), - Vrapim 600mF-800mM dhe dy teste nga mjeshhtëria e të mësuarit.	4 orë 5.4%
ATLETIKË	Vrapime Kërcime Hedhje Gara (në 2 disiplina)	Përsosje e mjeshhtërisë së vrapimit (teknikë), kërcimeve dhe hedhjeve përmes: - Vrapimit të shpejtë, - Vrapimit stafetar dhe rritjes së qëndrueshmërisë në shtigje më të gjata se 600m për femra dhe 800m për meshkuj. - Ushtrimeve për kërcyeshmëri. - Kërcimit së larti “fosberi”. - Hedhjes së tophave deri 300gr. - Shtytjes së gjyles 4kg. - GARA brenda e në mes të paraleleve së paku në dy disiplina ku duhet të rangohen nxënësit dhe grupëzohen në tri grupe sipas rezultateve.	12-14 orë 6.2-18.9 %

<p>GJIMNASTIKË SPORTIVE DHE RITMIKE</p>	<p>Kërcime</p> <p>Ushtrime në dysHEME</p> <p>Në hekur</p> <p>Në unaza</p> <p>Në paralele</p> <p>Në traun gjimnastikor</p> <p>Në kali me dorëza</p> <p>Valle popullore dhe vallëzim modern</p>	<p>- Kërcimi i kaluqit për së gjati me këmbë hapur e mbledhur.</p> <p>- Kërcimi i kalit për së gjati me këmbë hapur.</p> <p>- Ura nga qëndrimi i shtrirë - rrotullimi para me mbështetje në duar.</p> <p>- Rrotullimi prapa me mbështetje në duar.</p> <p>- Rrotullimi para dhe prapa me mbështetje në duar.</p> <p>- Rrotullimi para dhe mbapa nga mbështetja shaluar mbi duar (hekuri).</p> <p>- Nga lëkundja para dhe prapa kalim në varje palosur (unaza).</p> <p>- Nga lëkundje para dalje me kthim për 180°.</p> <p>- Nga mbështetje mbi krahë ngritje me lëkundje para në mbështetjen në duar. (paralele - meshkujt).</p> <p>- Lëkundje ballore në drushtin e lartë, në drushtin e ulët rrotullimi prapa dhe i shaluar, (paralele - femrat).</p> <p>- Përsëritje e elementeve të klasës së shtatë duke i komponuar.</p> <p>- Lëkundja nga mbështetja para dhe prapa.</p> <p>- Ushtrime përmes lëvizjeve ciklike e aciklike me topa, rrathë, litar e shishe druri. Hapat e valsit, rokut dhe dy valle popullore (vallet popullore dhe vallëzimi modern).</p> <p>- Brenda e mes paraleleve së paku në dy vegla.</p>	<p>10-12 orë 13.5-16.2%</p>

	Gara (2)		
SPORTE KOLEKTIVE	Futboll	<p>Pasimi dhe marrja e topit në lëvizje me kundërshtar gjysmaktiv dhe aktiv.</p> <p>Udhëheqja e topit gjysmaktiv dhe aktiv.</p> <p>Driblingu-mashtrimi me top dhe rrëmbimi i topit.</p> <p>Mbrojtja dhe sulmi grupor dhe ekipor.</p> <p>Futboll i vogël 7:7 me zbatim të rregullave elementare.</p>	
	Hendboll	<p>Përforcimi i lëvizjeve themelore (teknike) pa dhe me top si, gjuajtjet , pranimet, udhëheqjet etj.</p> <p>Stërvitja e formave të kundërsulmit grupor dhe kolektiv dhe të mbrojtjes individuale në gjysmën e fushës dhe në tërë fushën.</p> <p>Sulmi kolektiv me një pivot dhe mbrojtja zonale</p> <p>6:0 me kalim në atë 5:1 me arbitrim.</p>	26 orë
	Volejboll	<p>Përsëritja e lëvizjeve teknike si dëbimi, pasimi, marrja dhe gjuajtja e topit etj.</p> <p>Shërbimi nga lart "tenis" dhe blloku</p> <p>Volejboll 6:6 me zbatim të rregullave elementare.</p>	
	Basketboll	<p>Përforcim i elementeve tekniko-taktike si dhënia e topave bashkëlojtarit përmes formave lëvizore të ndryshme dhe gjuajtjeve në kosh etj.</p> <p>Loja 3:3, 4:4, me arbitrim.</p>	

	Gara	Brenda e mes paraleleve së paku në dy sporte kolektive.	
SPORTE INDIVIDUALE	Sportet luftarake- Xhudo	Njohja me teknikën themelore të lëvizjeve të xhudos si: kapjet e ndryshme rëniet etj.	
	Pingpong	Përsosje të teknikës themelore të goditjes me pëllëmbë me shpinë dhe goditje me rrotullim. Mësimi i shërbimeve bashkëkohore dhe i sistemeve të garave individuale e ekipore.	
	Roshula Gara (2)	Mësimi i lëvizjeve themelore të rrëshqitjes me rroshula si para, prapa me ndalje, lëvizje gjysmëharkore etj., me shpejtësi adaptuese. Brenda e mes paraleleve së paku në dy njësi mësimore të kaluara.	6-12 orë
Aktivitete në ujë 7-10 ditë	Teknikat e notit: Gara	Përsosja e stileve të mësuara (krol, bretkosë). Të mësuarit e krolit në shpinë dhe lojëra me kërcime të lira në ujë. Stil i lirë	7-10 ditë

<p>Aktivitete në borë 7-10 ditë</p>	<p>Disiplinat alpike Gara</p>	<p>Përsosje e teknikës themelore të rrëshqitjes me ski si ecje, kthime, lëshime (disiplina alpike). Lidhja e dy e më shumë kthimeve në terrene të përshtatshme për këtë grup-moshë . Në sllallom të madh në shteg të përshtatshëm për këtë grup- moshë.</p>	<p>7-10 ditë</p>
<p>Gara shkollore</p>	<p>Gara në sportet kolektive dhe individuale Krosi pranveror dhe vjeshtor</p>	<p>Së paku në dy degë sportive në kuadër të shkollës dhe ndërmjet shkollave të komunës, zonës e atyre finale e shtetërore për grup- moshë të caktuara me të dy gjinitë, krosi pranveror dhe vjeshtor</p>	<p>10-12 orë 16.2%</p>
<p>Shëtitje</p>	<p>Shëtitje në natyrë dy herë në vit</p>	<p>Ecja në natyrë me konfiguracion 6-12 km. Elemente të orientimit në natyrë dhe të kampingut (zgjedhja e kampit dhe vendosja e një tende). Lojëra të ndryshme të terrenit.</p>	

3.4 Çështjet ndërkurrikulare

Trajtimi i çështjeve ndërkurrikulare në kuadër të lëndës është një aspekt tjetër me shumë rëndësi pasi mundëson integrimin e fushave kurrikulare me qëllim të përkrahjes së nxënësve që të kuptojnë dhe interpretojnë drejt proceset shoqërore dhe natyrore që ndodhin në shoqëri.

Realizimi i çështjeve ndërkurrikulare ndihmojnë në zhvillimin dhe plotësimin e përmbajtjes së fushës për arritjen e të gjitha kompetencave të përcaktuara me Kornizën Kurrikulare të Kosovës.

“ Disa nga çështjet ndërkurrikulare që i ndihmojnë nxënësit në këtë nivel janë:

Globalizimi dhe ndërvarësia (i referohet bashkëveprimit, kombinimit të aftësive dhe mundësive për të krijuar gjera të përbashkëta, kombinimit të përpjekjeve me të tjerët për të arritur suksese më të mëdha).

Shrytëzimi i medias (i referohet përdorimit të mediave për sigurimin e informacioneve të reja dhe të drejta, krijimin dhe përdorimin e informatave, komunikimin përmes mediave tradicionale dhe digjitale, kritiken ndaj mediave, gjuhën e mediave dhe ndikimin e saj në shoqëri, pritjet e qytetarëve nga mediat dhe përdorimit të drejtë dhe të sigurtë).

Edukimi për zhvillim të qëndrueshëm (ekonomik, shërbimet për bashkësinë, siguria, mbrojtja e mjedisit natyror dhe human dhe zhvillimi i qëndrimeve ekologjike).

Gjuha dhe shkathtësitë e komunikimit në tërë kurrikulën (cilësia e mirë e komunikimit në të gjitha lëndët).

Zhvillimi personal dhe aftësitë për jetë (edukimi për konsumin dhe kursim, respekti për vete dhe për të tjerët, toleranca, vetëpërmbajtja, aftësia për marrëveshje, vetiniciativa dhe përgatitjet për të ardhmen).

Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm (i referohet temave me rëndësi të përgjithshme të cilat ndikojnë në ndërgjegjësimin e të rinjve, nxënësve për një qëndrim aktiv ndaj çështjeve dhe dukurive mjedisore, në nivel lokal dhe global).¹⁹


¹⁹Republika e Kosovës, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, “Programi i lëndorë Edukatë Fizike Sporte dhe Shëndeti”, Prishtinë 2016, faqe 8.

Kapitulli IV-Rezultatet

Të gjitha të dhënat e mbledhura nga pyetësi i zhvilluar në komunën e Vushtrrisë do të paraqiten edhe me anën e grafikoneve për të patur një pasqyrë rreth gjendjes reale të infrastrukturës nëpër shkolla për të mbajtur orën e lëndës mësimore.

4.1 Niveli pedagogjik në komunën e Vushtrrisë


Nga hulumtimi ynë del se niveli pedagogjik i arsimtarëve të lëndës së Edukatës Fizike në komunën e Vushtrrisë është në nivelin e kënaqshëm. Nga anketimi del tabela si në vijim:



Nga tabela shihet nga 21 të anketuar 11 prej tyre kanë kryer ose janë ende në studimet e masterit në këtë fushë, ndërsa 5 prej tyre në sistemin bachelor, kurse 3 prej tyre janë pjesë e sistemit të studimeve themelore ndërsa vetëm 2 prej tyre janë në sistemin e vjetër të shkollës së lartë pedagogjike 2 vjeçare.

4.2 Posedimi i sallës së Edukatës Fizike


Nga gjithsej gjashtëmbëdhjetë shkolla pjesëmarrëse në hulumtimin tonë, del që vetëm gjimnazi “Eqrem Çabej” posedon sallë të Edukatës Fizike.



Në pyetësin tonë ku flitet për gjendjen e sallave dhe kushteve të saj kemi vetëm një përgjigje meqë pra, vetëm një shkollë ka sallë të Edukatës Fizike.

4.3 Gjendja ekzistuese e sallës së Edukatës Fizike

Në pyetjen e gjendjes ekzistuese të sallës së Edukatës Fizike, meqë vetëm një shkollë posedon, është deklaruar se gjendja e sallës është e shkëlqyeshme.



Nga grafikoni shihet se 15 përgjigje japin përgjigje se gjendja e sallave është e dobët, ani pse kjo pyetje u është thënë se vlen vetëm për ato shkolla që posedojnë sallë, mirëpo si duket revoltimi i tyre për mungesë të sallave na sjellë pesëmbëdhjetë përgjigje që gjendja e sallave të edukatës fizike është e dobët.

4.4 Posedimi i poligoneve sportive

Shkollat e komunës së Vushtrrisë përveç problemit me salla të Edukatës Fizike, kanë probleme edhe me poligonet sportive.



Në përgjigjen e dhënë nga gjashtëmbëdhjetë shkolla, katër prej tyre kanë deklaruar se kanë mungesë të poligoneve sportive, pra vetëm dymbëdhjetë prej tyre posedojnë poligone sportive.

4.5 Gjendja ekzistuese e poligoneve sportive

Gjendja e poligoneve sportive në shkollat e komunës së Vushtrrisë është e ndryshme nëpër shkolla.



Në përgjigjet e dhëna shihet se kemi një shpërndarje të madhe nga infrastruktura nga shkolla në shkollë. Vetëm një shkollë është e kënaqur me gjendjen ekzistuese të poligoneve për zhvillimin e orës së Edukatës Fizike dhe katër prej tyre janë deklaruar se gjendja është e dobët, ndërkohë që pesë prej tyre e vlerësojnë si të shumë mirë, dy të mirë dhe katër prej tyre si hapësirë e mjaftueshme.


4.6 Hapësira e sallës së Edukatës Fizike

Meqë vetëm një shkollë kishte sallë të Edukatës Fizike, i anketuari është deklaruar se kjo sallë është e mjaftueshme për zhvillimin e lëndës së Edukatës Fizike.



4.7 Hapësira e poligoneve sportive në shkolla


Në opsionet e ofruara nga ne për tu përgjigjur rreth hapësirave të poligoneve sportive në shkolla, të anketuarit janë përgjigjur si në vijim:



Hapësira e këtyre poligoneve del të jetë e pamjaftueshme meqë dhjetë prej tyre vlerësojnë se kjo hapësirë nuk mjaftonë, ndërsa gjashtë prej tyre deklarojnë se kjo hapësirë është e mjaftueshme për të zhvilluar aktivitetet e lëndës së Edukatës Fizike.

4.8 Pajisja me rekuizita sportive nëpër salla

Duke ditur se në komunën e Vushtrrisë nga mostra jonë vetëm një shkollë pati sallë të Edukatës Fizike edhe përgjigjja për rekuizitat del të jetë me vetëm një përgjigje pozitive.



4.9 Shfrytëzimi i rekuizitave

Edhe sikur në përgjigjen më lartë edhe këtu pra, vetëm gjimnazi “Eqrem Çabej” posedonë mundësinë që të shfrytëzojë rekuizitat e sallës së Edukatës Fizike meqë edhe e posedonë atë.



4.10 Niveli i rekuizitave

Gjimnazi i komunës së Vushtrrisë edhe pse ka sallë të Edukatës Fizike, niveli i rekuizitave sportive nuk del të vlerësohet si i shkëlqyeshëm meqë i anketuari jonë deklaron se niveli i rekuizitave është i shumë mirë.



4.11 Posedimi i terreneve të hapura në shkolla


Se infrastruktura për mbajtjen e lëndës së Edukatës Fizike në komunën e Vushtrrisë është e dobët, vlerësohet edhe nga përgjigjja e dhënë nga të anketuarit kur dy prej shkollave nuk e posedojnë as edhe një hapësirë për zhvillimin e orës mësimore.



Nga ana tjetër katërmbëdhjetë shkolla të tjera deklarohen se posedojnë terrene të hapura në shkolla, për të zhvilluar lëndën.

4.12 Shrytëzimi i terreneve të hapura

Laramania e shrytëzimit të terreneve të hapura në shkollat e Vushtrrisë është si në grafikon:



Në grafikon shihet se vetëm katër prej shkollave e kanë të shkëlqyeshëm shfrytëzimin e terreneve të hapura, poashtu katër prej tyre deklarohen për shumë mirë, një thotë se shfrytëzimi i këtyre terreneve është i mirë, tre të tjerë deklarohen se këto terrene janë të mjaftueshme, ndërsa katër prej tyre e vlerësojnë si të dobët shfrytëzimin e terreneve të hapura.

4.13 Realizimi i planprogramit

Realizimi i planprogramit për lëndën e Edukatës Fizike në komunën e Vushtrrisë arrinë në 80%.



Realizueshmëria e planprogramit, prinë me 80%, pasur me 60% ndërsa dy shkolla tjera deklarohen se njëra e realizon 100% kurse tjetra vetëm 40%.

4.14 Pjesëmarrja e nxënësve në orën e Edukatës Fizike

Numri i orëve të Edukatës Fizike është 2 orë në javë, poashtu pjesëmarrja e nxënësve është 100% në lëndën e Edukatës Fizike. Në pyetjen e hapur që u kemi parashtruar, profesorët e kësaj lënde deklarohen të gjithë me përgjigje të njëjtë se askush nuk largohet nga ora e Edukatës Fizike, vetëm në raste kur nxënësit janë të sëmurë ose kanë munguar atë ditë.

4.15 Harmonizimi i nivelit shkollor me planprogramin mësimor

Vetëm një shkollë ka të harmonizuar planprogramin me nivelin shkollorë 100%.



Gjashtë shkolla të tjera kanë harmonizuar planprogramin me nivelin shkollorë 60%, ndërsa një shkollë tjetër vetëm 40%.

4.16 Harmonizimi i nivelit të edukimit të arsimtarit me planprogramin mësimor

Të gjithë profesorët përgjigjen se kanë të harmonizuar nivelin e edukimit të arsimtarit me planprogramin mësimor.



4.17 Zhvillimi i njësive mësimore


Edhe te zhvillimi i njësive mësimore vetëm një shkollë deklaroi se e zhvillon 100% një njësi mësimore.



Pasuar më 13 shkolla të tjera të cilat deklarohen se orën mësimore e zhvillojnë 80%, ndërsa dy të tjera vetëm 60%.

4.18 Zhvillimi i orës së Edukatës Fizike në teori


Zhvillimi i orës së Edukatës Fizike në teori në komunën e Vushtrisë prinë me 80% të shkollave.



Nga ana tjetër 4 shkolla zhvillimin e orës në teori thonë se e realizojnë 100%, po aq shkolla thonë se e realizojnë 40%, ndërsa dy prej tyre deklarohen se e realizojnë teorinë vetëm 40%, ndërkohë një deklarohet me vetëm 20%.

4.19 Zhvillimi i orës së Edukatës Fizike në praktikë


Nga mostra jonë e hulumtimit del se janë dy shkolla që e realizojnë 100% lëndën e Edukatës Fizike në praktikë.



Shumica e shkollave lëndën në praktikë e zhvillojnë 80%, ndërsa një 60%, por që një tjetër akoma më pak, ajo deklarohet me vetëm 40%.

4.20 Ambientet e mbajtjes së orës mësimore

Kushtet infrastrukturore në komunën e Vushtrrisë detyrojnë mësimdhënësit që të zhvillojnë orët mësimore si në grafikonin e paraqitur:



Meqë vetëm një shkollë nga mostra jonë posedon sallën e Edukatës Fizike, kjo shkollë aty edhe e zhvillon orën mësimore, por 6 shkolla të tjera detyrohen që orën ta zhvillojnë në klasa mësimi, 5 të tjera në poligone sportive dhe 4 të tjera në terrene të hapura.

Diskutime

Në një punim të kryer nga Besarta Seferi, me tematikë të njejtë por që i referohet komunës së Glllogocit dhe e cila si mostër ka ciklin fillor dhe të mesëm, por me një mostër më të vogël se ne, me gjithësej 8 shkolla, konstatohet se në këtë komunë niveli pedagogjik i arsimtarit në të shumtën e rasteve ka qenë me studime të mbaruara bachelor, pjesa tjetër kanë të kryer nivelin e studimeve master dhe në mesin e tyre ka pasur edhe nga një arsimtar me studime themelore dhe një me shkollë të lartë pedagogjike. Gjë që edhe në hulumtimin tonë del të jetë pothuajse e njejtë por që mostra ka bërë që niveli pedagogjik në komunën e Vushtrrisë të duket më i lartë. Në hulumtimin e saj del se në shkollat fillore në 41.67 % të rasteve ka pasur sallë të edukatës fizike, ndërsa te ato të mesme ka pasur sallë të edukatës fizike në 80% të rasteve. Këtu del se komuna e Vushtrrisë del të jetë më dobët me gjendjen e infrastrukturës shkollore meqë në shkollat fillore të komunës së Vushtrrisë në mostrën tonë janë 0% ndërsa në shkollat e mesme vetëm një shkollë posedon sallë të Edukatës Fizike. Si në hulumtimin e Besartes edhe në hulumtimin tonë del që hapësira për të zhvilluar lëndën e Edukatës fizike është e pamjaftueshme apo shumë e dobët. Në gjetjet e saj theksohet se “ gjendjen ekzistuese të sallave arsimtarët prej notës 1 deri në 5 e kanë vlerësuar me notën 3. Në shumicën e rasteve shkollat kanë poligone sportive, ato janë vlerësuar me notën 3, por hapësira e tyre është e pamjaftueshme. Terrenet sportive shfrytëzohen maksimalisht në shkollat fillore dhe të mesme dhe janë vlerësuar me notën 3 dhe 4. Planprogrami i lëndës së edukatës fizike realizohet prej 60-100% dhe numri i orëve të ed. Fizike është 2 orë në javë.”²⁰ Meqë kurrikula arsimore është në nivel Republike, numri i orëve mësimore edhe në komunën e Vushtrrisë del të jetë 2 orë në javë, por ajo çka vlenë të theksohet është se planprogrami në komunën që ne kemi hulumtuar ka raste kur bie edhe në 40% si shkakë i infrastrukturës për të zhvilluar këtë lëndë. Ndërsa për shfrytëzimin e terreneve të hapura vetëm katër prej shkollave e kanë të shkëlqyeshëm shfrytëzimin e terreneve të hapura, poashtu katër prej tyre deklarohen për shumë mirë, një thotë se shfrytëzimi i këtyre terreneve është i mirë, tre të tjerë deklarohen se këto terrene janë të mjaftueshme, ndërsa katër prej tyre e vlerësojnë si të dobët shfrytëzimin e terreneve të hapura.

²⁰ Seferi Besarta, Universiteti “Hasan Prishtina”, Fakulteti i Shkencave Sportive, Punim diplome Master, “Niveli pedagogjik dhe ndikimi i infrastrukturës sportive shkollore në realizimin e planprogramit të lëndës së edukatës fizike dhe sportit në komunën e Glllogocit”, Prishtinë 2015, faqe 40.

Përfundime

Infrastruktura lidhet ngushtë me zhvillimin e lëndës së edukatës fizike. Ndërlidhja mes vete e tyre bën që të lehtësohet puna në mbajtjen e lëndës mësimore teorike dhe praktike por po ashtu edhe në rritjen e kualitetit shëndetësorë dhe mendor të nxënësve. Shpesh infrastruktura bënë që nxënësit të ndalojnë, apo të vazhdojnë pasionin e tyre për sport, varësisht nga gjendja infrastrukturore që ata kanë nëpër shkollat e tyre.

Meqë në gjetjet tona u pa që ka raste kur shkollat e komunës së Vushtrrisë përveç mungesës së sallës së Edukatës Fizike, kanë edhe mungesë të infrastrukturës bazë meqë detyrohen që mësimin ta zhvillojnë edhe nëpër klasë dhe jo pak shkolla madje nuk kanë as hapësirë tjetër për të zhvilluar këto aktivitete, mund të vijmë në përfundime se:

1. Përgatitja profesionale e mësimeve të komunës së Vushtrrisë për mbajtjen e lëndës së Edukatës Fizike është e knaqshme.
2. Gjendja e infrastrukturës nëpër këto shkolla bënë që të zbehet rëndësia e lëndës së Edukatës Fizike.
3. Infrastruktura vendos nëse do të kemi shoqëri të shëndoshë dhe talent të rinjë në fushat sportive.

Kufizimet dhe rekomandimet

Kufizimet:

Ndër kufizimet e këtij punimi konsiderojmë që janë pjesëmarrja e vetëm një komune.

Numri i vogël i hulumtuesve, meqë ky punim ka karakter punim diplome master.

Rekomandime:

Rekomandime për studiuesit:

Rekomandojmë që kushdo që i çaset kësaj tematike, le të përgatit një kosto monetare meqë hapsira gjeografike e shkollave nëpër fshatra është e ndryshme.

Rekomandojmë poashtu, që për të patur një pasqyrë sa më të gjerë në territorin e Republikës së Kosovës, të organizohet një ekipë e përbashkët hulumtuesish.

Rekomandime për Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë dhe Ministrinë e Rinisë dhe Sportit:

Hapi i parë që duhet marrë është gjetja e një mesii bashkëpunimi për ngritjen e kapaciteteve infrastrukturale për mbajtjen e lëndës së Edukatës Fizike ashtu siç edhe e parashehë Kurrikula Bërthamë, e dalë nga Ministria e Arsimit.

Në mungesë të kushteve dhe në gjendjen aktuale të rishikohet planprogrami për lëndën e Edukatës Fizike.

Organizimi i lojërave garuese në të gjitha llojet e sportit edhe jashtë aktiviteteve mësimore, ku përfshihen të gjithë nxënësit veç e veç, në lojërën apo aktivitetin fizik ku ata besojnë që janë më të mirë.

Bibliografia

1. Bajçinca-Brestovci Shqipe, “Pedagogjia sportive”, Universiteti “Hasan Prishtina”, ligjeratë e autorizuar, Prishtinë 2014.
2. Hasangjekaj Beqir, “Metodika e edukatës fizike”, botues, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë 1998.
3. <https://fshs.uni-pr.edu/Historiku.aspx> .
4. Matthews, Bob&Ross, Liz (2010). *Metodat e hulumtimit. Udhëzues praktik për shkencat sociale dhe humane*. Përkthyer. Majlinda Nishku dhe Ilir Nishku. Tiranë: Qendra për Arsim Demokratik.
5. Republika e Kosovës, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, “Kurrikula Bërthamë ”, gusht 2016.
6. Republika e Kosovës, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, “Udhëzues për zbatimin e kurrikulës, Fusha kurrikulare, Edukatë Fizike, Sportet dhe Shëndeti”, Tetor 2016.
7. Republika e Kosovës, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, “Programi lëndorë Edukatë Fizike Sporte dhe Shëndeti”, Prishtinë 2016
8. Sallauku Dritan, Baze Elvira, “Edukimi Fizik dhe Sporte”, Republika e Shqipërisë, Instituti i Zhvillimit të Arsimit, Udhëzues Kurrikularë, Tiranë 2010.
9. Vehapi Shemsedin, “Konceptet e Edukimit Fizik dhe Edukimit Shëndetësor”, Universiteti “Hasan Prishtina”, ligjeratë e autorizuar, Prishtinë 2014.
10. Seferi Besarta, Universiteti “Hasan Prishtina”, Fakulteti i Shkencave Sportive, Punim diplome Master, “Niveli pedagogjik dhe ndikimi i infrastrukturës sportive shkollore në realizimin e planprogramit të lëndës së edukatës fizike dhe sportit në komunën e Glllogocit”, Prishtinë 2015

Aneks-Pyetëtori**PYETËSOR**

1. Niveli pedagogjik i arsimtarit?

a.Shkolla e lartë pedagogjike (2 vjeçare)

b.Studimet themelore

c.Studimet bachelor

d.Studimet master

e.Studimet magjistraturë

f.Studimet doktoraturë

Nëse keni ndonjë nivel arsimor që nuk është përfshirë më lartë shëno me fjalë:

2. Gjendja e infrastrukturës sportive në shkollë?

a. A posedon shkolla juaj sallë të edukatës fizike dhe sportit?

PO JO

(Nëse përgjigjja është PO kalo në pyetjen b)

b. Sa është e kënaqshme gjendja ekzistuese e sallës së edukatës fizike dhe sportit ?

(Shëno në katrorët 5 e kënaqshme, ndërsa 1 nuk është e kënaqshme)

5 4 3 2 1

c. A posedon shkolla juaj poligone sportive?

(Nëse përgjigja është PO kalo në pyetjen d)

PO JO

d. Sa është e kënaqshme gjendja ekzistuese e poligoneve sportive?

5 4 3 2 1

e. Sa ka hapësira mbrenda sallave të edukatës fizike dhe sportit?

mjaftueshëm pamjaftueshëm

f. Sa është hapësira e poligoneve sportive nëpër shkolla?

mjaftueshëm pamjaftueshëm

g. A janë të pajisura me rekuizita sportive sallat e edukatës fizike dhe sportit në shkollën tuaj?

PO JO Pjesërisht

h. Sa janë të shfrytëzueshme rekuizitat sportive në sallën e edukatës fizike dhe sportit në shkollën tuaj?

5 4 3 2 1

Në çfarë niveli janë rekuizitat sportive që posedon salla e edukatës fizike dhe sportit në shkollën tuaj?

5 4 3 2 1

j. A ka shkolla terrene të hapura të cilat shfrytëzohen për realizimin e lëndës së edukatës fizike dhe sportit?

(nëse po kalo në pyetjen e k)

PO JO

k. Sa janë të shfrytëzueshme terrenet e hapura për realizimin e lëndës së edukatës fizike dhe sportit në shkollën tuaj?

5 4 3 2 1

Realizimi i lëndës së edukatës fizike dhe sportit për klasën e __

a. Sa realizohet planprogrami i orës së edukatës fizike dhe sportit?

100% 80% 60% 40% 20%

b. Sa është numri i orëve të lëndës së edukatës fizike dhe sportit për një javë?

c. Shëno numrin e nxënësve prezent gjatë orës së edukatës fizike dhe sportit.

d. Sa është i harmonizuar niveli shkollor me planprogramin mësimor?

100% 80% 60% 40% 20%

e. Niveli i edukimit (shkollor) të arsimtarit a është i harmonizuar me planin mësimor?

PO JO

f. Zhvillimi i njësive mësimore. Si e zhvilloni një njësi mësimore në lëndën e edukatës fizike dhe sportit apo (sa përqind e zhvilloni një njësi mësimore në lëndën e edukatës fizike dhe sportit)?

100% 80% 60% 40% 20%

g. Sa përqind e realizoni orën mësimore të lëndës së edukatës fizike dhe sportit me teori dhe përqind me praktikë?

Teori

100% 80% 60% 40% 20%

Praktikë

100% 80% 60% 40% 20%

h. Cilat ambiente të punës i shfrytëzoni për realizimin e orës mësimore që posedon shkolla?

sallën e edukatës fizike dhe sportit

klasën mësimore

terrenet e hapura

poligonet sportive